

Ministri Bushati zhvillon takime në Pentagon dhe në Departamentin e Shtetit

2017-04-21 09:26:00



Në kuadër të vizitës së tij në Washington Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati zhvilloi takime në Departamentin e Shtetit dhe në Pentagon, me Zv. Sekretarin e Shtetit, Thomas Shannon, si dhe me Nën-Sekretaren e Politikave të Mbrojtjes, Theresa Whelan.

Në takimin me Zv. Sekretarin e Shtetit, Tom Shannon, bashkëbiseduesit trajtuan forcimin e bashkëpunimit midis dy vendeve në kuadër të partneritetit strategjik, si dhe rritjen e bashkëveprimit në përballjen e sfidave të përbashkëta siç është lufta kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Ministri Bushati e njohu Zv. Sekretarin e Shtetit me zhvillimet e brendshme, duke u ndalur te reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare, kryesisht reforma në drejtësi dhe përpjekjet për zbatimin e vetting-ut.

Teksa rikonfirmoi partneritetin e ngushtë midis dy vendeve, Zv. Sekretari Shanon nënvizoi "mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara për zbatimin e reformës në drejtësi si dhe angazhimin e përbashkët në mbrojtje të vlerave të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut".

Ministri Bushati falënderoi Zv. Sekretarin Shanon "për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara për Shqipërinë dhe rajonin, në forcimin e paqes, stabilitetit demokratik dhe reformave shtet-konsoliduese".

Në këtë kontekst, Shannon bëri thirrje që "të gjitha partitë politike në Shqipëri të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare".

Bashkëbiseduesit u ndalën mbi zhvillimet e fundit në rajon, rolin konstruktiv të Shqipërisë në forcimin e bashkëpunimit rajonal, si dhe rëndësinë e kontributit të vendit tonë në përmirësimin e mjedisit të sigurisë në Europën Jug-Lindore.

Palët ranë dakord se progresi i reformave shtet-konsoliduese dhe fryma e bashkëpunimit, në frymën e vlerave dhe perspektivës euro-atlantike, mbeten akset kryesorë të përforcimit të paqes dhe stabilitetit demokratik në rajonin tonë.

Në takimin me Nën-Sekretaren e Politikave të Mbrojtjes, Theresa Whelan, Ministri Bushati falënderoi SHBA-të për mbështetjen e gjithanshme që i kanë dhënë Shqipërisë në reformën e sektorit të sigurisë dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura.

Biseda pati në fokus nevojën e forcimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, në përgjigje edhe të sfidave të sigurisë me të cilat po përballë hapësira euro-atlantike.

Ministri Bushati e njohu Whelan me rolin e shtuar të Shqipërisë në misionet dhe operacionet e NATO-s, si dhe mbi kontributin e saj të qenësishëm në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Bushati rikonfirmoi vendosmërinë e vendit tonë për të vijuar me materializimin e angazhimeve të marra në Samitet e NATO-s në Uells dhe Varshavë, përfshirë rritjen e buxhetit dhe investimeve në fushën e mbrojtjes.

Bashkëbiseduesit thekëuan nevojën e një vëmendje të shtuar ndaj

rajonit dhe të bashkëndimit të përpjekjeve për të forcuar stabilitetin demokratik dhe përmirësuar mjedisin e sigurisë.